



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 555/ 6 prot

Datë 08.04.2024

V E N D I M
Nr. 353/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.04.2024 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr.REF-96533-02-27-2024, me objekt: “Largim perpunim i mbeturinave (urbane) dhe pastrim i teritorit nga dëbora, Spitali Korçë” – Marreveshje Kuader - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj”, me fond limit 1,312,649.5 (një milion e treqind e dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e nëntë pikë pesë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 11.03.2024, nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Shërbimit Spitalor Korçë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Rej” SHPK me NIPT J93711608Q, me adresë: Zogu i Zi, Qatar Center, Kati 2, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Shërbimit Spitalor Korçë.
Adresa: Shetitore “Fan S. Noli” Korçë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë

13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 28.02.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr.REF-96533-02-27-2024, me objekt: “Largim përpunim i mbeturinave (urbane) dhe pastrim i territorit nga dëbora, Spitali Korçë” – Marrëveshje Kuader - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj”, me fond limit 1,312,649.5 (një milion e treqind e dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e nëntë pikë pesë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 11.03.2024, nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Shërbimit Spitalor Korçë.

II.2. Në datën 05.03.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/3865 dhe me nr. 555/2024 protokoli, i operatorit ekonomik “Rej” SHPK, mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit me përmbajtje si më poshtë vijon:

Operatori ekonomik “Rej” Shpk, duke qene i interesuar për te marrë pjesë ne procedurën e prokurimit publik te siperpërmendur, ka analizuar me kujdes kriteret e veçanta per kualifikim, Specifikimet teknike dhe preventivin e sherbimeve për kete objekt. Per sa me sipër paraqesim ankesen tone me argumentet si me poshte vijon:

A. Duke marre shkas dhe nga shume AK analoge si Bashkia Tirane, Bashkia Himare, Bashkia Korce etj., keto lloj sherbimesh jane parashikuar te kryhen për disa vite, 3-5 dhe jo për një 2 vite sic eshte parashikuar nga Drejtoria e Sherbimit Spitalor Korce.

B. Ky lloj sherbimi kompleks kerkon nje lloj te vecante organizimi dhe zbatimi duke qen se investimi në mjete, pajisje dhe fuqi punetore eshte tepër e larte dhe për 2 vite për ne si ofertues është e pamundur perballimi i kostove te ketij sherbimi kur nderkohë kemi te bejme me nje situatë teper delikate te inflacionit dhe rritjes se cmimeve te lendes se pare per kryerjen e ketij sherbimi dhe ndryshimet e rritjes se pages minimale here -pas here. Kerkojme nga AK rishikimin e afatit te kryerjes se sherbimit te Evadimit te Mbetjeve Urbane, nga 2 vite në te pakten 3 ose 4 vite. Pasi keshtu edhe per vete AK dhe komunitetin do te kursehej koha e kryerjes se procedurave per kete prokurim dhe te mos gjendet ne situata te tilla ku mund te ngelet pa këte sherbim. Imagjironi nese ky sherbim nuk do te kryhej qofte edhe nje dite cfare impakti do të kete ne mjedis dhe ne shendetin e qytetarëve dhe pacientëve???. Sherbimi i Pastrimit eshte nje nga detyrat kryesore ku Ak duhet te mirëmenaxhoje si kryerjen e procedurave te prokurimit Publik ashtu dhe zbatimin e saj. Per sa me sipër i kerkojme AK te marre parasysh konstatimet e paraqitura nga ne dhe zgjatjen e afatit për kryerjen e ketij shërbimi.

C. Ne specifikimet teknike konstatojme se Fondi Limit nuk eshte hartuar ne perputhje me VKM nr. 319 date 31.05.2018 “Per miratimin e masave per kostot e menaxhimit te integruar te mbetjeve”. Duke u nisur nga specifikimet teknike e publikuara në SPE, ne kemi kryer perlllogaritjet sipas VKM nr. 319 date 31.05.2018 “Per miratimin e masave per kostot e menaxhimit te integruar te mbetjeve” dhe na rezulton qe fondi limit nuk eshte i saktë por eshtë disa herë më i ulët si vlerë. Kërkojme nga ju si Ak perlllogaritjen e sakte te fondit limit nga nje ekspert të fushes për llogaritjen e sakte te fondit sipas përcaktimeve ligjore ne fuqi. Gjithashtu në mbeshetje te konstatimit tone ju sjellim ne vemendje vendimin e KPP Nr. 147/2022 Përlllogaritja e kostos se menaxhimit të mbetjeve e referuar sipas VKM nr. 319 date 31.05.2018 Per miratimin e masave për kostot e menaxhimit te integruar te mbetjeve konsiston ne perdorimin e shtojces nr. 1 te ketij vendimi. Kjo shtojce i eshte shpërndare ne formatin template excel të gjithë perfaqësuesve të pushtetit vendor te RSH ne kuader te nje trajnimi periodik vjetor te kryer nga

ASPA pergjate viteve 2017-2019 për menaxhimin e integruar te mbetjeve. Ne këte model është e nevojshme që të futen disa te dhëna kyce apo të perditësohen disa nga te ashtuquajturat variabla fikse te cilat mund të ndryshojne si pasoje e ndryshimit te ligjit (paga minimale) apo të tregut (cmimi i karburantit, cmimi i siguracioneve) kursi i këmbimit te monedhes). Edhe Bashkia Shkodër ne dokumentacionin e dërguar ka perdorur këte template excel per llogaritjen e kostos se menaxhimit te mbetjeve. - Te dhëna kyc qe kerkon ky template jane Numri aktual i popullsisë se zones ku do te kryhet sherbimi i menaxhimit te mbetjeve (nr.); -Sasia e gjenerimit te mbetjeve për fryme (kg mbetje/banor/dite); - Tipologjia e zonës (urbane, rurale, gjysme urbane); - Distanca e grumbullimit te mbetjeve; - Distanca e transportit te mbetjeve; - Frekuenca javore e grumbullimit te mbetjeve; - Tonazhi i mjeteve/kamioneve qe do te kryejne kete proces (ton). Ne nenin 21 te ligjin 162/2020 per prokurimin publik parashikohet se Autoriteti ose enti kontraktor eshte përgjegjes për prokurimin ne përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe te akteve nenligjore te nxjerra ne zbatim te tij, duke garantuar respektimin e parimeve te trajtimit te barabarte, transparences, konkurrences dhe mosdiskriminimit, te parashikuara ne kete ligj. Ne kuptim te kesaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin te mireplanifikoje ne cilesi dhe ne kohe fondet publike e nevojat e tij dhe te prokuroje e te zbatoje kontratën ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Per sa me siper argumentuam kerkojme nga AK perlllogaritjen e sakte te fondit limit. Autoriteti kontraktor duhet te perllogarise vlerën e kontratës bazuar ne specifikimet teknike te procedures se prokurimit.

D. Konstatojme se nuk eshte hartuar nje preventive me zerat e punimeve te sherbimeve te kerkuara ku te paraqesim cmimit ne menyre qe të plotësojme ofertën ekonomike, por AK eshte mjaftuar vetem me shpjegim ne specifikimet teknike ku ka përcaktuar se "Evadimi i mbetjeve do te kryhet çdo ditë, nga e hëna ne te diele, ne oret e vona te darkes ose natën, me mjete motorike profesionale, dhe do te transportohen ne vendgrumbullimin e mbetjeve urbane (lanfilli Maliq), ku kryhet edhe perpunimi i metejshem i tyre", ku nuk ka përcaktuar sesi do te paguhet depozitimi i ketyre mbetjeve ne landfillin e Maliqit duke gene se depozitimi ka nje kosto te konsiderueshme.

E. Po ashtu AK ne specifikimet teknike ka përcaktuar se - Operatori ekonomik kontraktues detyrimisht kryen larjen e kontenierëve me uje dhe solucion, minimumi 1 (nje) herë ne muaj, si dhe disinfektimin e konteniereve dhe truallit te vendgrumbullimit me klor çdo dite; - Operatori ekonomik kontraktues duhet te beje hapjen dhe kripezimin e rrugeve brenda teritorit te spitalit, nga debora gjatë muajve të dimrit; - Operatori ekonomik kontraktues, duhet te pastroje rrugët e brendëshme te Bllokut Spitalor nga bora, ne te gjithë gjatësinë e tyre, me mjete borëpastruese, si dhe të beje kripezimin e tyre sipas standartit (0.015kg/m2 rrugë), për te garantuar rrugë të pastra dhe pa probleme ne qarkullimin e mjeteve gjate periudhës se dimrit. Per keto sherbime AK nuk i ka parashikuar si zera ne preventivte cilat kanë një sasi dhe nje kosto te caktuar dhe nuk mundet sesi OE te perballoje me shpenzimet e veta, mbi të gjitha te mos paguhet. Kerkojme nga Ak hartimin e Preventivit ku te perfshihen te gjithë zerat e sherbimeve dhe punimeve të kerkuara nga Ak.

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimesit.

II.4. Me shkresën nr. 460 prot, datë 08.03.2024, protokolluar me tonën me shkresën nr. 555/2 prot., datë 12.03.2024, me objekt “Dërgim informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik dokumentacioni dhe informacioni i autoritetit kontraktor, si dhe akti i trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik “Rej” SHPK, nëpërmjet së cilës ka vendosur mospranimin e ankesës me argumentet si më poshtë vijon:

Ne date 05.03.2024, jemi vene ne dijeni ne lidhje me ankesen e bere nga operatori ekonomik “Rej” shpk, me NIPT J93711608Q, perfaqesuar nga administratori z/L. K ne lidhje me dokumentat e tenderit te kesaj procedure prokurimi. Menjehere pas marrjes se kesaj ankese me urdher me nr 422 prot, date 05.03.2024, te titullarit te Autoritetit Kontraktor eshte vendosur;

Pezullimi i procedures se prokurimit me objekt si me siper, deri ne shqyrtimin perfundimtar te akneses, si dhe ngritja e komisionit per shqyrtimin e ankeses. Komisioni i shqyrtimit te ankeses i ngritur me urdher me nr 422 prot, date 05.03.2024 te Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Sherbimit Spitalor Korce per tenderin me objekt “Largim perpunim i mbeturinave (urbane) de pastrim i teritorit nga debora, Spitali Korçe” - Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara” me afat 24 muaj.

Ne zbatim te Ligjit 162 dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe ne VKM nr. 285 dt. 19.05.2021 “Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, nisur nga ankesa e operatorit ekonomik “Rej” shpk, me NIPT 193711608Q, perfaqesuar nga administratori z/L. K, pasi i njoh me ankesen si dhe me dokumentacionin e mbajtur nga AK per kete procedure prokurimi, mori ne shqyrtim kete ankese duke analizuar si vijon;

Ankesa e operatorit ekonomik “Rej” shpk, me NIPT J93711608Q, perfaqesuar nga administratori z/L. K, konsinston;

- 1- Kerkon nga AK rishikimin e afatit te kryerjes se ketij sherbimi, nga 2 vite ne te pakten 3 ose 4 vite.*
- 2- Kerkon nga AK hartimin e Preventivit ku te perfshihen te gjithë zerat e sherbimeve dhe punimeve te kerkuara nga AK.*

Ne lidhje me kerkesen e pare Autoriteti Kontraktor eshte bazuar ne:

- a) Ligjin 162 dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 52 “Marrëveshjet kuadër”, ku midis te tjerash percaktohet; “Afati i marreveshjes kuadër nuk eshte me i gjatë se 4 vjet”,*

- b) ne VKM nr. 285 dt. 19.05.2021 “Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, te ndryshuar, neni 63 “Kohezgjatja e një marrëveshjeje kuader”, paragrafi i pare ku shprehet “Kohëzgjatja e nje marreveshjeje kuader nuk mund te jete me shume se 4 (katër) vjet”.
- c) ne orinetimet dhe rekomandimet e bera nga Agjencia e Prokurimit Publik (perdorimi i marreveshjes kuader per nje periudhe kohore prej dy vjecare).
- d) si dhe ne argumentimin se nje procedure prokurimi me teper me kete natyre sherbimi, shume vjecare (mbi 2 vjet) mund te krijonte probleme ne realizimin e saj per shkak te ndryshimeve qe mund te kishte kryesisht ne cmimin e sherbimit dhe ndryshime te tjera objektive qe mund ta bente te veshtire realizimin e saj, ka vendosur qe kjo procedure te jete marreveshje kuader me afat kohor prej 2 (dy) vjetesh.

Duke analizuar per sa me siper mendojme se afati kohor prej 2 (dy) vitesh i percaktuar nga AK, per kete procedure prokurimi eshte i drejte i bazuar ne ligj dhe i argumentuar ne kerkesa ligjore dhe objektive. Ne keto kushte kerkesa e pare e operatorit ekonomik Rej shpk, me NIPT J93711608Q, perfaqesuar nga administratori z/L. K, nuk qendron dhe si e tille nuk merret ne konsiderate.

Ne lidhje me kerkesen e dyte sqarojme si vijon; Autoriteti kontraktor per te percaktuar fondin limit per kete procedure prokurimi eshte bazuar ne VKM nr. 285 dt. 19.05.2021 “Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, te ndryshuar, neni 76 “Mënyrat per perlllogaritjen e vleres së prokurimit”

1. Ne perlllogaritjen e vleres limit te kontrates, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shume alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

- a) cmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe cmime te tjera zyrtare, te njohura nga institucionet perkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtise, ne manuale etj.): ose/dhe
- b) studimit te tregut, bazuar në mesataren e cmimeve te marra nga ky studim; ose/dhe
- c) cmimet e kontratave të mëparshme, te realizuara nga vetë apo nga autoritete te tjera kontraktore; ose/dhe
- ç) cmimet nderkombëtare te shpallura publikisht.

Analizojme pikat e mesiperme:

- a) cmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe cmime te tjera zyrtare, te njohura nga institucionet perkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, ne manuale etj.); (per kete procedure prokurimi me kete objekt prokurimi ne dijenine tone nuk ka cmime sipas kerkeses se kesaj pike).
- b) studimit te tregut, bazuar në mesataren e cmimeve te marra nga ky studim; Komisioni i ngritur me Urdhrine Brendshem Nr.8, nr. 164 prot. date 29.01.2024, “Mbi ngritjen e grupit te punes për percaktimin e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe argumentimin e

nevojave për procedurën e prokurimit me objekt “Evadim i mbetjeve urbane, te Spitalit Korçë për periudhën 24 mujore (2024 - 2025)”, fillimisht u bazua ne metodën e testimit te tregut, për te marre informacion mbi çmimin për njësi (lekë/dite pa TVSH), duke iu drejtuar me ftesë për oferte ne date 31.01.2024, ne rruge elektronike, tete operatorëve ekonomike te fushes se evadimit dhe perpunimit te mbetjeve urbane me te cilet SR Korce ka pasur dhe ka marredhënie te ngjashme por edhe ata qe kanë rezultuar nga kerkimi ne QKR si me poshte:

LEKA - 2007 shpk; NIPT: K77929501L Adresa: Lezhë, Lagjja Beslidhja. Rruga “Luigj Gurakuqi”, Zyre ne zonën kadastrale nr.8632, numri i pasurise 7/195-N17, kati I -re.

ZEQIRI shpk; NIPT: J67902827A Adresa: Fier, Lagjja “Bishanak”, Rruga “Skenderbeu”, Zona Kadastrale 5532, banese private. Pasuria nr. 1/1088, Kati I- rë.

RECYCLING shpk; NIPT: L28029301Q Adresa; Fshati Gurez, aferish - Kanalit te Acidit LEZHË.

KORSEL shpk; NIPT: J64104124G Adresa: Korçe, Lagjja 17, Rruga “Midhi Kostani”, Prane Hipotekës, Objekti Nr. 23.

REJ shpk; NIPT: J93711608Q Adresa: Tiranë, Zogu i Zi, Qatar Center, kati 2. (Subjekti ankimues).

Pastrime Silvio shpk; NIPT: K91413010N Adresa: Tiranë, Njësia Bashkiake nr. 2, Rruga “Fatmir Haxhiu”, Pallati 2, Shk. 10, Ap 76, Kati I – re.

GRIALD shpk; NIPT J68117216C Adresa: Kukës, Lagjja e Re, Rruga Uzines, Zona Kadastrale Nr.2315, Nr. Pasurie 51/62, Lokal.

BEST-T CAPITAL INVEST shpk; NIPT M02326007E Adresa: Tirane. Njesia Bashkiake Nr.5, Rruga “Prokop Mima”, Hyrja 1, Ap.43, Shk.2.

Afati i fundit per dorezimin e ofertave ishte data 09/02/2024 duke i lene mundesine OE- ve te përgatisin oferte ekonomike per kete objekt prokurimi. (Dokumentacioni bashkelidhur relacionit).

Gjate kesaj periudhe kohore te percaktuar ne Ftesen per oferte si më sipër, prane Spitalit Rajonal Korce nuk u paraqit asnje oferte ekonomike nga subjetet te cilave iu referuan. Referuar procedurës ligjore, mungesa e ofertave ekonomike e anulon procedurën e testimit te tregut. Per ketë arsye, ne vijim grupi i punës vendosi të referohet ne nje nga metodat e tjera te parashikuara ne ligj për përlllogaritjen e fondit limit per prokurim, dhe konkretisht mesatarizimit te cmimeve te kontratave te fundit te realizuara nga ana e Spitalit Rajonal Korçe.

Grupi i punes konstaton se pranë institucionit tone kemi kontrata te ngjashme për evadimin e mbetjeve urbane dhe pastrimin e rrugëve nga debora, të cilat janë realizuar mbi bazën e Marrveshjeve Kuader respektive, marrëveshje te lidhura per periudha 2 - vjeçare, dhe konkretisht grupi i punes u referua në:

- Kontrata Nr. 1315 prot. date 01.10.2021 “Largim, përpunim i mbetjeve (urbane) dhe pastrim i territorit nga dëbora, Spitali Korçe”, lidhur mbi Marreveshjen Kuader nr. 497 prot. date 25.03.2020, per periudhen 2020 - 2022.

- Kontrates Nr. 207 prot. date 01.02.2024 “Largim, përpunim i mbetjeve (urbane) dhe pastrim i territorit nga dëbora, Spitali Korçe”, lidhur mbi Marreveshjen Kuader nr. 538 prot. date 25.03.2022, per periudhen 2022 - 2024. (Kontratat bashkelidhur relacionit)

Grupi i punes bazuar ne kete metodike, perlllogariti cmimin mesatar për sherbimin si me poshte:

Nr	Emertimi sherbimit	Njesia	Cmimi kontrata 01.10.2021	Cmimi kontrata 01.02.2024	Cmimi mesatar
1	Evadim mbetjesh urbane dhe territori rrugesh nga bora	leke / dite pa TVSH	1884	1712.3	1798.15

Per sa me sipër, bazuar ne tabelën bashkalidhur ketij relacioni, si dhe ne faktin se periudha 24 - mujore për prokurim eshte 730 dite kalendarike Vlera Totale e kesaj procedure prokurimi eshte: $1798.15 \text{ leke / dite pa TVSH} \times 730 \text{ dite} = 1\,312\,649.5 \text{ leke pa TVSH}$.

Referuar pikes 1 te nenit 34 te Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe pikes 1 te nenit 12 te VKM-se nr.285/2021 “Për miratimin e rregullave te prokurimit publik”. eshte e percaktuar se, llogaritja e vleres se parashikuar te nje prokurimi, bazohet ne shumën totale qe duhet paguar pa TVSH, për “Evadim i mbetjeve urbane”, te Spitalit Korçe per 24 muaj (2024 - 2025)” objekt i Urdhrit Nr. 8, me nr. 164 prot, date 29.01.2024, vlera totale e perlllogaritur per 24 muaj eshtë 1,312,649.5 (nje milion e treqind e dymbedhjete mije e gjashteqind e dyzet e nente pike pesë) Leke pa TVSH.

Pra per sa me siper ndodhur ne kushtet e shtjelluara AK eshte referuar tek; kriteri

c) cmimet e kontratave të meparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete te tjera kontraktore;

ç) çmimet nderkombetare te shpallura publikisht, (per kete procedure prokurimi me kete objekt prokurimi ne dijenine tone NUK ka cmime sipas kerkeses se kesaj pike).

Duke analizuar per sa me siper mendojme se perlllogaritja e fondit limit per kete procedure prokurimi eshte i bazuar ne ligj, pra perlllogaritja e fondit limit per kete procedure prokurimi eshte bere ne nje nga menytrat ligjore te percaktuar ne VKM nr. 285 dt. 19.05.2021 “Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, te ndryshuar, neni 76 “Menytrat per perlllogaritjen e vlerës se prokurimit”.

Ne keto kushte edhe kerkesa e dyte e operatorit ekonomik "Rej" shpk, me NIPT J93711608Q, perfaqesuar nga administratori z/L. K, nuk qendron dhe si e tille nuk merret ne konsiderate.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "Rej" SHPK se: *"Operatori ekonomik "Rej" Shpk, duke qene i interesuar për te marrë pjesë ne procedurën e prokurimit publik te siperpërmendur, ka analizuar me kujdes kriteret e veçanta per kualifikim, Specifikimet teknike dhe preventivin e sherbimeve për kete objekt. Per sa me sipër paraqesim ankesen tone me argumentet si me poshte vijon: A. Duke marre shkas dhe nga shume AK analoge si Bashkia Tirane, Bashkia Himare, Bashkia Korce etj., keto lloj sherbimesh jane parashikuar te kryhen për disa vite, 3-5 dhe jo për një 2 vite sic eshte parashikuar nga Drejtoria e Sherbimit Spitalor Korce. B. Ky lloj sherbimi kompleks kerkon nje lloj te vecante organizimi dhe zbatimi duke qen se investimi në mjete, pajisje dhe fuqi punetore eshte tepër e larte dhe për 2 vite për ne si ofertues është e pamundur perballimi i kostove te ketij sherbimi kur nderkohë kemi te bejme me nje situatë teper delikate te inflacionit dhe rritjes se cmimeve te lendes se pare per kryerjen e ketij sherbimi dhe ndryshimet e rritjes se pages minimale here pas here. Kerkojme nga AK rishikimin e afatit te kryerjes se sherbimit te Evadimit te Mbetjeve Urbane, nga 2 vite në te pakten 3 ose 4 vite. Pasi keshtu edhe per vete AK dhe komunitetin do te kursehej koha e kryerjes se procedurave per kete prokurim dhe te mos gjendet ne situata te tilla ku mund te ngelet pa këte sherbim. Imagjioni nese ky sherbim nuk do te kryhej qofte edhe nje dite cfare impakti do të kete ne mjedis dhe ne shendetin e qytetarëve dhe pacientëve???. Sherbimi i Pastrimit eshte nje nga detyrat kryesore ku Ak duhet te mirëmenaxhoje si kryerjen e procedurave te prokurimit Publik ashtu dhe zbatimin e saj. Per sa me sipër i kerkojme AK te marre parasysh konstatimet e paraqitura nga ne dhe zgjatjen e afatit për kryerjen e ketij shërbimi."*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën "Njoftim i Kontratës", seksionin II "Objekti i Kontratës" pika 2.4 e në vijim të dokumenteve standarde të tenderit përcaktohet:

2.4 Kontrata në bazë të Marrëveshjes Kuadër:

Po X Jo

2.5 Lloji i Marrëveshjes Kuadër:

- Me një Operator Ekonomik**
- Me disa Operatorë Ekonomikë**
- Të gjitha kushtet janë të përcaktuara** Po Jo

2.6 Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik:

Në rastin e Marrëveshjes Kuadër me një Operator Ekonomik, kur janë përcaktuar të gjitha kushtet, më poshtë të jepen arsytet e përzgjedhjes

Ne zbatim të Ligjit 162 dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe në VKM nr. 285 dt. 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, për plotësimin e nevojave të Spitalit Korce në drejtim të shërbimit të “Largim perpunim i mbeturinave (urbane) dhe pastrim i teritorit nga dëbora, Spitali Korçë”, për periudhën kohore 24 muaj.

Lidhur me prokurimin e këtij objekti, janë të përcaktuara të gjitha kushtet kryesore të marrëveshjes kuadër të tilla si shërbimi që do të kryhet, specifikimet e sakta teknike, kushtet e rëndësishme të shërbimit.

Ndryshimi i OE në rast se kjo marrëveshje do të lidhej me disa OE (pra rrjedhimisht ku jo të gjitha kushtet do të ishin të përcaktuara) do të shkaktonte kosto shtesë, pasiguri dhe konfuzion për OE të suksesshëm. Lidhja e MK me një OE të vetëm, do të shoqërohej me mirëorganizimin e këtij të fundit për sigurimin e kryerjes së shërbimit në kohë. Gjithashtu siguria për kontratat që parashikohet të lidhen i jep mundësi OE të ulë kostot e ofertës.

Marrëveshja kuadër me disa OE ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara nuk konsiderohet kontratë. Kjo do të thotë që AK nuk kanë mekanizma detyruese për OE të shpallur të suksesshem për pjesëmarrjen e tyre në minikonkurse dhe rrjedhimisht në lidhjen e kontratave pas zhvillimit të tyre. Pasiguria dhe vonesat mund të sjellin dështime në kryerjen e shërbimit në kohën e duhur.

Nga eksperiencat e mëparshme të prokurimit të këtij objekti, ka rezultuar se numri i OE pjesëmarrës ka qenë i kufizuar për lot. Marrëveshja me kushte jo të përcaktuara do të kërkonte kualifikimin e tre OE gjë e cila rrezikon realizimin e procedurës.

Me qëllim garantimit të kryerjes së shërbimit në afatet kohore të përcaktuara, MK me një OE të vetëm të suksesshem do të garantonte sigurinë e kryerjes së shërbimit sipas kushteve të përcaktuara dhe brenda afateve të kërkuara duke sjellë stabilitet në menaxhimin e kontratave dhe të nevojave të AK.

2.7 Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë:

Numri i operatorëve ekonomikë, me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër: ___ (Këtu, duhet të përcaktohet numri maksimal i operatorëve ekonomikë, me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër)

2.8 Kushtet që duhet të zbatohen në rastin e rihapjes së konkurrimit:

		Nuk do të ketë rihapje të konkursit. Kontratat do të lidhen sipas kërkesave të AK, me operatorin ekonomik të suksesshëm, i cili do të ofrojë çmimin më të ulët. Dhënia e kontratave do të behet nga DSHSKorce.
--	--	---

2.9 Autoriteti Kontraktor/Autoritetet kontraktore që do të jenë palë në Marrëveshjen Kuadër: (këtu duhet të listohen të gjitha autoritetet kontraktore që do të jenë palë përfituese nga marrëveshja kuadër) _____

2.10 Përshkrimi i shkurtër i kontratës / Marrëveshjes Kuadër

1. Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **1,312,649.5** (nje milion e treqind e dymbëdhjete mijë e gjashtëqind e dyzet e nente pike pese) leke pa TVSH, ose **1,575,179.4** (nje milion e pesëqind e shtatëdhjete e pese mijë e njëqind e shtatëdhjete e nente pike kater) leke me TVSH.

2. Në rastin kur, objekti i prokurimit përbëhet nga disa shërbime, **shumatorja e çmimeve për njësi është** _____

3. Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit

4. Kodi Output: 91304AA

5. Tipi:

Investime Kodi: _____ Vlera: _____

Shërbime **X** Kodi: 1013019 Vlera: **1,312,649.5** (njemilion e treqind e dymbëdhjete mijë e gjashtëqind e dyzet e nente pike pese) leke pa TVSH, ose **1,575,179.4** (nje milion e pesëqind e shtatëdhjete e pese mijë e njëqind e shtatëdhjete e nente pike kater) leke me TVSH.

2.11 Kohëzgjatja e kontratës ose afati i zbatimit të kontratës:

Kohëzgjatja në muaj ose ditë (rast pas rasti sipas nevojave të AK)

Ose

Fillon më mbaron më

2.11.1. Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër:

Kohëzgjatja në muaj: 24 ose ditë: _____ (nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër)
<i>Ose fillon më</i> ____/____/____ (d/m/v)
mbaron më ____/____/____ (d/m/v)

III.1.2. Në shtojcën 7 “*Termt e Referencës*”, pjesë e dokumenteve standarde të tenderit përcaktohet:

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: “Largim perpunim i mbeturinave (urbane) dhe pastrim i teritorit nga dëbora, Spitali Korçë” .

Detyrat: “Largim perpunim i mbeturinave (urbane) dhe pastrim i teritorit nga dëbora, Spitali Korçë”.

Shpërndarja: 24 Muaj.

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Prane bllokut Spitalor Korce dhe prane Poliklinikës se specialiteve Korce.

III.1.3. Në nenin 2 “*Qëllimi*” të ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndërkohë në nenin 3 “*Parime të përgjithshme*” të ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.4. Në nenin 4 “Përkufizime” pika 27 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Marrëveshje kuadër” është një marrëveshje ndërmjet një apo më shumë autoriteteve ose enteve kontraktore dhe një a më shumë operatorëve ekonomikë, qëllimi i së cilës është të vendosë kushtet e kontratave, që do të prokurohen gjatë një periudhe të caktuar kohore, veçanërisht ato që kanë lidhje me çmimin dhe, aty ku është e përshtatshme, me sasinë e parashikuara.

III.1.5. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

III.1.6. Në nenin 52 “Marrëveshjet kuadër” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” shprehimisht thuhet se:

1. Marrëveshja kuadër është marrëveshja ndërmjet një ose më shumë autoriteteve ose enteve kontraktore dhe një ose më shumë operatorëve ekonomikë, qëllimi i së cilës është të vendosë kushtet e kontratave që do të jepen gjatë një periudhe të caktuar kohore, veçanërisht ato që kanë lidhje me çmimin dhe, aty ku është e përshtatshme, me sasinë e parashikuara.

Afati i marrëveshjes kuadër nuk është më i gjatë se 4 vjet.

Në rastin e marrëveshjes kuadër për kontratat sektoriale, ky afat nuk është më i gjatë se 8 vjet.

2. Kontratat e bazuara në një marrëveshje kuadër lidhen në përputhje me procedurat e parashikuara në këtë ligj.

Këto kontrata mund të zbatohen vetëm ndërmjet atyre autoriteteve ose enteve kontraktore që janë identifikuar qartë për këtë qëllim në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi dhe atyre operatorëve ekonomikë që janë palë të marrëveshjes kuadër që është lidhur.

Kontratat e bazuara në një marrëveshje kuadër në asnjë rrethanë nuk mund të përfshijnë ndryshime thelbësore të kushteve të përcaktuara në marrëveshjen kuadër, veçanërisht në rastin e përmendur në pikën 3 të këtij neni.

3. Kur një marrëveshje kuadër lidhet me një operator të vetëm ekonomik, kontratat e bazuara në këtë marrëveshje lidhen brenda kufijve të kushteve të përcaktuara në marrëveshjen kuadër.

Për dhënien e këtyre kontratave, autoritetet ose entet kontraktore i kërkojnë operatorit ekonomik palë në marrëveshjen kuadër ofertën e tij, sipas nevojës.

4. Kur marrëveshja kuadër lidhet me më shumë se një operator ekonomik, atëherë kjo marrëveshje kuadër zbatohet në një nga mënyrat e mëposhtme:

a) nëpërmjet zbatimit të kushteve të parashtruara në marrëveshjen kuadër, pa rihapur konkurrimit;

b) kur marrëveshja kuadër përcakton të gjitha kushtet që rregullojnë ofrimin e punëve, shërbimeve dhe furnizimeve në fjalë, pjesërisht pa rihapur konkurrimit në përputhje me shkronjën “a” të kësaj pike, dhe pjesërisht me rihapjen e konkurrimit ndërmjet operatorëve ekonomikë, palë të marrëveshjes kuadër, në përputhje me shkronjën “c” të kësaj pike, kur kjo mundësi është parashikuar nga autoritetet ose entet kontraktore në dokumentet e tenderit për marrëveshjen kuadër. Zgjedhja nëse punët, furnizimet ose shërbimet specifike blihen pas rihapjes së konkurrimit ose direkt sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjen kuadër bëhet në përputhje me kritere objektive, të cilat përcaktohen në dokumentet e tenderit për marrëveshjen kuadër. Në këto dokumente duhet, gjithashtu, të specifikohet se cilat kushte mund t'i nënshtrohen rihapjes së konkurrimit.

Mundësitë që parashikohen në paragrafin e parë të kësaj shkronje, gjithashtu, zbatohen për çdo lot të marrëveshjes kuadër, për të cilët të gjitha kushtet që rregullojnë ofrimin e punëve, shërbimeve dhe furnizimeve në fjalë përcaktohen në marrëveshjen kuadër, pavarësisht nëse janë përcaktuar ose jo të gjitha kushtet që rregullojnë ofrimin e këtyre punëve, shërbimeve dhe furnizimeve për lote të tjera.

c) kur në marrëveshjen kuadër, nëpërmjet rihapjes së konkurrimit ndërmjet operatorëve ekonomikë, palë të marrëveshjes kuadër, nuk janë përcaktuar të gjitha kushtet që rregullojnë ofrimin e punëve, shërbimeve dhe furnizimeve.

5. Konkurrimet e përmendura në shkronjat “b” dhe “c” të pikës 4 bazohen në të njëjtat kushte që zbatohen për dhënien e marrëveshjes kuadër dhe, nëse është e nevojshme, në bazë të kushteve të formuluar më saktësisht dhe, sipas rastit, në kushte të tjera të përcaktuara në dokumentet e tenderit, në përputhje me procedurën në vijim:

a) për çdo kontratë që do të prokurohet, autoritetet ose entet kontraktore komunikojnë me shkrim ose me mjete elektronike me palët në marrëveshjen kuadër;

b) autoritetet ose entet kontraktore duhet të caktojnë një afat jo më pak se 2 ditë për dorëzimin e ofertave për secilën kontratë specifike, duke marrë parasysh kompleksitetin e objektit që do të prokurohet dhe kohën e nevojshme për të dorëzuar ofertat;

c) ofertat do të dorëzohen me shkrim ose me mjete elektronike dhe përmbajtja e tyre duhet të mbetet konfidenciale, derisa kufiri i përcaktuar kohor për përgjigje të ketë skaduar;

ç) autoritetet ose entet kontraktore do t'i japin kontratën ofertuesit, që ka dorëzuar ofertën më të mirë, në bazë të kritereve të shpalljes së kontratës fituese, të përcaktuara në dokumentet e tenderit të marrëveshjes kuadër.

III.1.7. Në nenin 74 të ligjit 162/2021 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: 46 “1. Autoriteti ose enti kontraktor, në hartimin e dokumenteve të tenderit, përdor dokumentet standarde, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit publik dhe i vë në dispozicion falas në rrugë elektronike.”.

III.1.8. Në nenin 77 pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, shprehimisht thuhet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”

III.1.9. Në nenin 60, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht:

Një marrëveshje kuadër mund të lidhet ndërmjet:

- a) disa autoriteteve/entete kontraktore dhe disa operatorëve ekonomikë;
 - b) disa autoriteteve/entete kontraktore dhe një operatori ekonomik;
 - c) një autoriteti/enti kontraktor dhe disa operatorëve ekonomikë;
 - ç) një autoriteti/enti kontraktor dhe një operatori ekonomik.
2. Në njoftimin e procedurës së prokurimit duhet të përcaktohen të gjitha autoritetet/entet kontraktore përfutuese. Nuk mund të bëhen pjesë e një marrëveshje kuadër autoritetet/entet kontraktore, të cilat nuk janë palë e marrëveshjes kuadër që në publikimin e saj. Pas nënshkrimit të marrëveshjes, nuk lejohet të pranohen operatorë ekonomikë të tjerë, të cilët nuk janë palë në këtë marrëveshje.
 3. Operatorët ekonomikë, që janë palë në një marrëveshje kuadër, nuk mund të krijojnë një bashkim operatorësh ekonomikë dhe të paraqesin ofertë për një kontratë, pasi janë bërë palë e kësaj marrëveshjeje kuadër.
 4. Operatori ekonomik, që është palë në një marrëveshje kuadër, nuk mund të caktohet si nënkontraktor i një operatori ekonomik tjetër, që i është dhënë kontrata sipas së njëjtës marrëveshjeje kuadër.

III.1.10. Në nenin 61, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht:

1. Një marrëveshje kuadër është e përshtatshme për mallra dhe shërbime të përdorura zakonisht me natyrë të përsëritur dhe/ose kur është e vështirë ose e pamundur për të përcaktuar paraprakisht volumet që duhet të prokurohen, dhe nuk ka siguri për kohën e ekzekutimit të kontratave.
2. Një marrëveshje kuadër është ligjërish e detyrueshme për të dyja palët. Autoriteti/enti kontraktor nuk është i detyruar të prokurojë një sasi të caktuar mallrash/shërbimesh/punësh të përfshira në marrëveshje, por, në çdo rast gjatë kohëzgjatjes së marrëveshjes kuadër, autoritetet/entet kontraktore nuk lejohen të blejnë nga asnjë operator ekonomik tjetër të njëjtat mallra/shërbime/punë të mbuluara nga një marrëveshje kuadër, pasi kjo do të konsiderohej një shkelje e marrëveshjes.

III.1.11. Në nenin 62, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht:

1. Autoritetet/entet kontraktore mund të lidhin një marrëveshje kuadër nëpërmjet procedurave të prokurimit të parashikuara në LPP.
2. Njoftimi për marrëveshjen kuadër hartohet dhe publikohet në sistemin e prokurimit publik dhe Buletinin e Njoftimeve Publike, në përputhje me LPP-në dhe me këto rregulla. Çdo operator ekonomik i interesuar mund të paraqesë një ofertë në procedurën për dhënien e një marrëveshjeje kuadër.
3. Afatet kohore minimale për pranimin e ofertave për këtë procedurë janë ato të parashikuara në nenin 52, të LPP-së.
4. Përlllogaritja e vlerës së marrëveshjes kuadër bëhet, si më poshtë vijon:
 - a) Vlera e parashikuar e një marrëveshjeje kuadër duhet të përfshijë shumën e përlllogaritur të të gjitha vlerave të kontratave që parashikohen të jepen gjatë kohës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër.
 - b) Në rastin kur, autoriteti/enti kontraktor e ka të pamundur të përcaktojë sasinë e objektit të prokurimit, për efekt të përlllogaritjes së vlerës së marrëveshjes kuadër duhet t’u referohet, për aq sa është e mundur, nevojave të planifikuara dhe/ose nevojave të mëparshme për këtë objekt. Në çdo rast, përlllogaritja e nevojave duhet të jetë sa më e plotë dhe gjithëpërfshirëse, me qëllim shmangien e situatave kur dalin nevoja të reja, për të njëjtin objekt, të papërfshira në marrëveshjen kuadër.
5. Operatorët ekonomikë përzgjidhen si palë të marrëveshjes kuadër duke zbatuar kriteret e përcaktimit të ofertës fituese, sipas përcaktimeve të neneve 80 dhe 87, të LPP-së. Në rast se autoriteti/enti kontraktor e ka objektivisht të pamundur të përcaktojë sasinë që do të prokurohet, atëherë do të vlerësojë ofertën/ofertat fituese duke u bazuar në çmimin për njësi.
Kur, autoriteti/enti kontraktor vendos vlerësimin e ofertave mbi bazën e “çmim për njësi”, përveç vlerës së pritshme të kontratave përlllogarit edhe shumatoren e çmimeve për njësi për çdo

artikull apo shërbim, e cila publikohet bashkë me vlerën e pritshme të kontratave, në njofimin e kontratës. Në këtë rast, ofertimi nga operatorët ekonomikë do të bëhet me shumatoren e çmimeve për njësi. Për efekt krahasimi, vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet mbi bazën e shumatores së çmimeve për njësi, të përlogaritur për çdo artikull apo shërbim nga autoriteti/enti kontraktor .

Kjo metodë vlerësimi nuk do të përdoret nga autoritetet/entet kontraktore, kur sasi të janë të llogaritshme në bazë vjetore sipas eksperiencës së mëparshme, dhe kur marrëveshja kuadër përdoret për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme. Në këtë rast, çmimi i ulët do të vlerësohet me vlerën totale më të ulët të ofruar.

6. Nëse një operator ekonomik, palë në marrëveshjen kuadër, nuk përmbush më kriteret e kualifikimit, për të cilat është shpallur fitues në këtë marrëveshje, është i detyruar të njoftojë autoritetin/entin kontraktor menjëherë, por jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga momenti i ndodhjes së një ndryshimi të tillë. Në rast se autoriteti/enti kontraktor konstaton mospërmbushjen e këtij detyrimi, duhet të veprojë në përputhje me nenin 78, të LPP-së.

7. Në rast se operatorët ekonomikë palë në një marrëveshje kuadër, për shkak të forcës madhore (lufta ose revolucionet, zjarri, përmytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo transiti) nuk mundet që të furnizojnë autoritetin/autoritetet kontraktore palë në këtë marrëveshje, me një ose disa artikuj/shërbime objekt i kësaj marrëveshje, atëherë vlefshmëria dhe efektiviteti marrëveshjes pushojnë së ekzistuari vetëm për këto artikuj/shërbime, dhe vijon për artikujt/shërbimet e tjera, sipas kushteve të marrëveshjes.

8. Autoriteti/enti kontraktor harton dhe publikon njoftimin e fituesit për një marrëveshje kuadër në përputhje me LPP-në dhe këto rregulla. Në përfundim të afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor fton ofertuesin/t fitues për nënshkrimin e marrëveshjes.

III.1.12. Në nenin 63, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht:

1. Kohëzgjatja e një marrëveshjeje kuadër nuk mund të jetë më shumë se 4 (katër) vjet.
2. Në rastin e marrëveshjes kuadër për kontratat sektoriale, ky afat nuk është më i gjatë se 8 (tetë) vjet.

III.1.12. Në nenin 64, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht:

1. Llojet e marrëveshjes kuadër janë:

- a) marrëveshje kuadër e lidhur me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara;
- b) marrëveshje kuadër e lidhur me disa operatorë ekonomikë, ku:
 - i. të gjitha kushtet janë të përcaktuara;
 - ii. jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

2. *Kontratat e bazuara në marrëveshjet kuadër të lidhura me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, duhet të akordohen brenda kufijve dhe kushteve të parashikuara në marrëveshjen kuadër. Në kontratat e bazuara në marrëveshjen kuadër nuk mund të bëhen ndryshime të kushteve, për të cilat është lidhur marrëveshja, pasi kjo do të konsiderohej shkelje e marrëveshjes kuadër.
Nëse nevojat e autoritetit/entit kontraktor ndryshojnë, atëherë do të duhet të prokurojë një marrëveshje kuadër të re. Një operatori ekonomik i kërkohet të përgatisë ofertën e tij për kontratën bazuar në marrëveshjen kuadër vetëm në lidhje me kushtet, për të cilat është rënë dakord paraprakisht në marrëveshjen kuadër.*
3. *Kontratat e bazuara në marrëveshjet kuadër të lidhura me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, duhet të akordohen brenda kufijve dhe kushteve të parashikuara në marrëveshjen kuadër. Meqenëse këto marrëveshje kuadër vlerësohen si kontrata, nuk lejohet të bëhen ndryshime të kushteve të tyre, pasi kjo do të konsiderohej shkelje e kontratës. Nëse nevojat e autoritetit kontraktor ndryshojnë, atëherë autoriteti kontraktor duhet të prokurojë një marrëveshje kuadër të re.
Në rast të përdorimit të kësaj lloji marrëveshjeje, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë në dokumentet e tenderit kushtet që do të zbatohen për dhënien e kontratave brenda marrëveshjes kuadër. Në çdo rast, dhënia e kontratave do të bëhet pa rihapur konkurrimin, duke u bazuar në kushtet e përcaktuara në marrëveshjen kuadër.
Kjo lloji marrëveshjeje përdoret në rastin e ndarjes së objektit të prokurimit në lote, ku për çdo lot do të përcaktohet një operator ekonomik fitues.
Marrëveshjet kuadër me disa operatorë ekonomikë duhet të lidhen me të paktën tre operatorë ekonomikë. Në rast të kundërt, autoritetet/entet kontraktore mund të lidhin marrëveshje kuadër me ato operatorë ekonomikë që i kanë përmbushur të gjitha kriteret, me kusht që të jenë të paktën dy.*
4. *Marrëveshjet kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara, nuk konsiderohen kontrata, sipas LPP-së.
Në rast të përdorimit të kësaj lloji marrëveshjeje, autoriteti/enti kontraktor, për të lidhur kontratë brenda marrëveshjes kuadër, duhet të rihapë konkurrimin.
Autoriteti/enti kontraktor përgatit një ftesë për ofertë dhe ia dërgon vetëm operatorëve ekonomikë palë të marrëveshjes kuadër, pa bërë njoftim publik. Ftesa për ofertë drejtuar operatorëve ekonomikë duhet të përcaktojë afatin kohor për dorëzimin e ofertave, kriteret për shpalljen e ofertës fituese për kontratën e bazuar në marrëveshjen kuadër dhe çdo informacion të nevojshëm për përgatitjen e ofertave.
Në këto dokumente duhet, gjithashtu, duhet të specifikohet se, cilat kushte mund t'i nënshtrohen rihapjes së konkurrimit.
Kriteret për shpalljen e ofertës fituese gjatë rihapjes së konkurrimit mund të jenë të njëjta si ato të marrëveshjes kuadër, ose autoriteti/enti kontraktor mund të përdorë kritere të tjera, me kusht që ato të jenë të përcaktuara në dokumentet fillestare të marrëveshjes kuadër. Këto*

kritere mund të jenë çmimet për volume të caktuara, informacion për konsulencat për një shërbim intelektual, koha e nevojshme për dorëzim ose orët e nevojshme për kryerjen e punimeve specifike.

Komunikimi ndërmjet autoritetit/entit kontraktor dhe operatorëve ekonomikë, palë të marrëveshjes kuadër, për përzgjedhjen e fituesit për kontratat bëhet në formë të shkruar ose elektronike dhe, në çdo rast, duhet të dokumentohet dhe të bëhet pjesë e dosjes së procedurës. Forma e komunikimit përzgjidhet nga autoriteti/enti kontraktor, në varësi të kohës në dispozicion për përmbushjen e nevojës. Autoriteti/enti kontraktor është përgjegjës për të ruajtur konfidencialitetin e përmbajtjes së ofertave, deri në vlerësimin përfundimtar të tyre.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet t'u dërgojë, në të njëjtën kohë, ftesën për ofertë të gjithë operatorëve ekonomikë, palë të marrëveshjes kuadër.

Kjo lloj marrëveshjeje kuadër nuk është e zbatueshme në rastet e kontratave sektoriale.

III.1.13. Në nenin 65, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht:

1. *Operatorët ekonomikë janë të detyruar të zbatojnë kontratën sipas cilësisë dhe çmimit të ofertuar, në kohën e kërkuar prej autoriteteve kontraktore.*

2. *Për dhënien e kontratave sipas marrëveshjes kuadër zbatohen këto rregulla:*

a) *Kontratrat mund të jepen mbi bazën e marrëveshjes kuadër përgjatë gjithë kohës së vlefshmërisë së saj. Periudha e vlefshmërisë së kontratave të lidhura mbi bazën e një marrëveshjeje kuadër mund të kalojë periudhën e vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër.*

b) *Në rastin e marrëveshjes kuadër ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara, gjatë rihapjes së konkurrimit autoriteti/enti kontraktor krijon një komision vlerësimi për dhënien e një kontrate në bazë të marrëveshjes kuadër.*

Nuk është e detyrueshme që përbërja e komisionit të jetë e njëjtë me atë të komisionit të vlerësimit të ofertave, të përcaktuar për kryerjen e procedurës së prokurimit për marrëveshjen kuadër.

c) *Dhënia e kontratave në bazë të një marrëveshjeje kuadër të realizuar nga një autoritet/ent kontraktor në cilësinë e organit qendror blerës do të bëhet nga vetë autoritetet/entet kontraktore përfituese.*

ç) *Autoritetet/entet kontraktore do t'i japin kontratën ofertuesit, që ka dorëzuar ofertën më të mirë, në bazë të kriterëve të shpalljes së kontratës fituese, të përcaktuara në dokumentet e tenderit të marrëveshjes kuadër.*

d) *Në një marrëveshje kuadër, sasi të parashikuara janë vetëm “sasi orientuese”. Autoriteti/enti kontraktor mund të blejë më pak ose më shumë se sasi të parashikuara (por në çdo rast brenda vlerës së përlllogaritur të marrëveshjes kuadër).*

3. *Autoriteti/enti kontraktor harton dhe publikon njoftimin e fituesit për një kontratë bazuar në marrëveshjen kuadër në përputhje me LPP-në dhe këto rregulla. Në përfundim të afateve të ankimit fton fituesin për nënshkrimin e kontratës.*
4. *Në rastin e marrëveshjeve kuadër, të realizuara nga një autoritet/ent kontraktor, njoftimi i kontratave të lidhura gjatë një viti kalendarik do të dërgohet për publikim në sistemin e prokurimit elektronik nga autoriteti/enti kontraktor.*
5. *Në rastin e marrëveshjeve kuadër, të realizuara nga një autoritet/ent kontraktor në cilësinë e organit qendror blerës, njoftimi i kontratave të lidhura gjatë një viti kalendarik do të dërgohet për publikim, në sistemin e prokurimit elektronik nga autoriteti/enti kontraktor, prokurues në cilësinë e organit qendror blerës.*

III.1.14. KPP-ja gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në vendimin e GJED Çështja C-368/10 “Komisioni Europian vs. Mbretëria e Holandës” inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: *“Kriteret për kualifikim/Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larinë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen kriteret/specifikime teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.”* Në interpretim të dispozitave ligjore të fushës së prokurimit, vlen të theksojmë se së pari, ligjvënësi ka parashikuar dy natyra kriteresh kualifikimi, kriteret të cilat përcaktohen me ligj, si dhe kriteret dhe kërkesat të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në përputhje me llojin, volumin, sasinë, specifikat e shërbimit që kërkohet të prokurohet, me qëllim realizimin me sukses dhe cilësi të tij. Kriteret e përcaktuara me ligj mund të parashikohen nga ligji për prokurimin publik dhe rregullat në përputhje me të, ashtu sikurse në rastin konkret në lidhje me afatin e marrëveshjes kuadër, ku neni 52 pika 1 e LPP parashikon se *afati i marrëveshjes kuadër nuk është më i gjatë se 4 vjet*, si dhe neni 63 pika 1 e VKM-së 285, për miratimin e rregullave të prokurimit publik parashikon se *kohëzgjatja e një marrëveshjeje kuadër nuk mund të jetë më shumë se 4 (katër) vjet*. Komisioni i Prokurimit Publik, referuar legjisllacionit vëren se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, përcaktimi i afatit të marrëveshjes kuadër është lënë në të drejtën e autoritetit kontraktor, por gjithmonë duke respektuar afatin maksimal të vendosur nga ligjvënësi

që është jo më shumë se 4 vite. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati i përcaktuar në seksionin 2 “Kohëzgjatja e kontratës ose afati i zbatimit të kontratës 24 muaj” është konsideruar i mjaftueshëm për realizimin në kohë të objektit të prokurimit, duke iu referuar sasisë dhe grafikut të lëvritimit. Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, shqyrtimi i dokumenteve të tenderit komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor nw DST ka përcaktuar se afati i marrëveshjes kuadër është 24 muaj si dhe në interpretim literal të bazës ligjore të sipërcituar, konkretisht nenit 52 pika 1 e LPP që parashikon se *afati i marrëveshjes kuadër nuk është më i gjatë se 4 vjet*, si dhe nenit 63 pika 1 e VKM-së 285, për miratimin e rregullave të prokurimit publik, ku parashikohet se *kohëzgjatja e një marrëveshjeje kuadër nuk mund të jetë më shumë se 4 (katër) vjet*. Komisioni vlerëson, se kriteri në lidhje me afatin e kohëzgjatjes së marrëveshjes kuadër është në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara për sa kohë që afati i marrëveshjes kuadër është brenda diapazonit të përcaktuar nga ligjvënësi dhe e mbështetur në ligjin specifik *lex specialis* dhe akoma më tej nuk krijon diskriminim për operatorët ekonomikë për sa kohë është dhe një kriter ligjor. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se për sa kohë një detyrim i tillë është i përcaktuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë afatin e marrëveshjes kuadër, në përputhje me dispozitat ligjore, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij për afatin e marrëveshjes kuadër prej 24 muaj, në këtë procedurë prokurimi nuk ka kufizuar konkurrencën, pasi një kriter i tillë nuk është diskriminues për operatorët ekonomikë dhe është brenda diapazonit të përcaktuar nga ligjvënësi.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK nuk qëndron.

III.2 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK se: *“Ne specifikimet teknike konstatojme se Fondi Limit nuk është hartuar në përputhje me VKM nr. 319 date 31.05.2018 “Per miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”. Duke u nisur nga specifikimet teknike e publikuara në SPE, ne kemi kryer përlllogaritjet sipas VKM nr. 319 date 31.05.2018 “Per miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve” dhe na rezulton që fondit limit nuk është i saktë por është disa herë më i ulët si vlerë. Kërkojme nga ju si Ak përlllogaritjen e sakte të fondit limit nga një ekspert të fushës për llogaritjen e sakte të fondit sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Gjithashtu, në mbështetje të konstatimit tone ju sjellim në vëmendje vendimin e KPP Nr. 147/2022 Përlllogaritja e kostos së menaxhimit të mbetjeve e referuar sipas VKM nr. 319 date 31.05.2018 Per miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve konsiston në perdorimin e shtojces nr. 1 të këtij vendimi. Kjo shtojce i është shpërndarë në formatin template excel të gjithë përfaqësuesve të pushtetit vendor të RSH në kuadër të një trajnimi periodik vjetor të kryer nga ASPA përgjate viteve 2017-2019 për menaxhimin e integruar të mbetjeve. Në këtë model është e nevojshme që të futen disa të dhëna kyçe apo të perditësohen disa nga të ashtuquajturat variabla fikse të cilat mund të ndryshojnë si pasojë e ndryshimit të ligjit (paga minimale) apo të tregut (cmimi i karburantit,*

cmimi i siguracioneve) kursi i këmbimit të monedhes). Edhe Bashkia Shkodër në dokumentacionin e dërguar ka përdorur këtë template excel për llogaritjen e kostos së menaxhimit të mbetjeve. - Të dhëna kyç që kërkon ky template janë Numri aktual i popullsisë së zonës ku do të kryhet shërbimi i menaxhimit të mbetjeve (nr.); -Sasia e gjenerimit të mbetjeve për frymë (kg mbetje/banor/dite); - Tipologjia e zonës (urbane, rurale, gjysmë urbane); - Distanca e grumbullimit të mbetjeve; - Distanca e transportit të mbetjeve; - Frekuenca javore e grumbullimit të mbetjeve; - Tonazhi i mjeteve/kamioneve që do të kryejnë këtë proces (ton). Në nenin 21 të ligjit 162/2020 për prokurimin publik parashikohet se Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nenligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mireplanifikojë në çilesi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Për sa më sipër argumentuam, kërkojmë nga AK për llogaritjen e saktë të fondit limit. Autoriteti kontraktor duhet të përlllogarisë vlerën e kontratës bazuar në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit. D. Konstatojmë se nuk është hartuar një preventiv me zerat e punimeve të shërbimeve të kërkuara ku të paraqesim cmimin në mënyrë që të plotësojmë ofertën ekonomike, por AK është mjaftuar vetëm me shpjegim në specifikimet teknike ku ka përcaktuar se "Evadimi i mbetjeve do të kryhet çdo ditë, nga e mërkura në të diele, në orët e vona të darkës ose natën, me mjete motorike profesionale, dhe do të transportohen në vendgrumbullimin e mbetjeve urbane (landfilli Maliq), ku kryhet edhe perpunimi i metejshëm i tyre", ku nuk ka përcaktuar sesi do të paguhet depozitimi i këtyre mbetjeve në landfillin e Maliqit duke qenë se depozitimi ka një kosto të konsiderueshme. E. Po ashtu AK në specifikimet teknike ka përcaktuar se - Operatori ekonomik kontraktues detyrimisht kryen larjen e kontejnerëve me ujë dhe solucion, minimumi 1 (një) herë në muaj, si dhe disinfektimin e kontejnerëve dhe truallit të vendgrumbullimit me klor çdo ditë; - Operatori ekonomik kontraktues duhet të bëjë hapjen dhe kripezimin e rrugëve brenda territorit të spitalit, nga debora gjatë muajve të dimrit; - Operatori ekonomik kontraktues, duhet të pastrojë rrugët e brendshme të Bllokut Spitalor nga bora, në të gjithë gjatësinë e tyre, me mjete borëpastruese, si dhe të bëjë kripezimin e tyre sipas standardit (0.015kg/m² rrugë), për të garantuar rrugë të pastra dhe pa probleme në qarkullimin e mjeteve gjatë periudhës së dimrit. Për këto shërbime AK nuk i ka parashikuar si zera në preventiv të cilat kanë një sasi dhe një kosto të caktuar dhe nuk mundet sesi OE të perballojë me shpenzimet e veta, mbi të gjitha të mos paguhet. Kërkojmë nga Ak hartimin e Preventivit ku të përshihen të gjithë zerat e shërbimeve dhe punimeve të kërkuara nga Ak", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën "Njoftim i Kontratës", seksionin II, pika 2.10, e dokumenteve standarde të tenderit përcaktohet:

2.10.1. Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **1,312,649.5** (një milion e treqind e dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e nëntë pike pesë) leke pa TVSH, ose **1,575,179.4**

(nje milion e peseqind e shtatedhjete e pese mije e njeqind e shtatedhjete e nente pike kater) leke me TVSH.

III.2.2. Në shtojcën 5 “*Formulari i specifikimeve teknike*”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi është përcaktuar si më poshtë:

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Specifikimet teknike, termat e references, shërbimi dhe grafiku i levrimit:

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Shërbimet që kërkohen të realizohen nëpërmjet kësaj kontrate janë: “Largim perpunim i mbeturinave (urbane) dhe pastrim i teritorit nga dëbora, Spitali Korçë”

Për realizimin e këtij procesi sqarojme si vijon:

1. Drejtoria e Shërbimit Spitalor Korçë disponon 2 (dy) pika grumbullimi mbetjesh, një pranë Bllokut Spitalor dhe një pranë Poliklinikës Qëndrore të qytetit.

2. Operatori ekonomik kontraktues duhet të pajisë këto pika me kontenjerë metalike 500 litroshë dhe kontenjerë plastikë 120 litroshë, dhe konkretisht 5 (pesë) kontenjerë metalikë dhe 3 (tre) kontenjerë plastikë në pikën pranë Bllokut Spitalor, dhe 1 (një) kontenjer metalik pranë Poliklinikës. Kontenjerët janë në pronësi të operatorit ekonomik kontraktues.

3. Operatori ekonomik kontraktues duhet të menaxhojë portën e jashtme të vendgrumbullimit të mbetjeve pranë Bllokut Spitalor, duke garantuar pamundësinë e futjes së personave të tretë në këtë pikë.

4. *Evadimi i mbetjeve do te kryhet çdo ditë, nga e hëna në të dielë, në orët e vona të darkës ose natën, me mjete motorike profesionale, dhe do të transportohen në vendgrumbullimin e mbetjeve urbane (lanfilli Maliq), ku kryhet edhe përpunimi i mëtejshëm i tyre.*
5. *Operatori ekonomik kontraktues duhet të plotësojë fletën e evadimit të mbetjeve për periudhën, tip standart, (e rakorduar nga të dy palët kontraktuese), duke ia bashkëngjitur faturës tatimore përkatëse.*
6. *Operatori ekonomik kontraktues është përgjegjës për riparimin dhe zëvendësimin e kontenierëve të dëmtuar, duke garantuar grumbullimin e mbetjeve pa probleme.*
7. *Operatori ekonomik kontraktues detyrimisht kryen larjen e kontenierëve me ujë dhe solucion, minimumi 1 (një) herë në muaj, si dhe disinfektimin e kontenierëve dhe truallit të vendgrumbullimit me klor çdo ditë.*
8. *Operatori ekonomik kontraktues duhet te beje hapjen dhe kripezimin e rrugeve brenda teritorit te spitalit, nga dëbora gjatë muajve të dimrit.*
9. *Operatori ekonomik kontraktues, duhet të pastrojë rrugët e brendshme të Bllokut Spitalor nga bora, në të gjithë gjatësinë e tyre, me mjete borëpastruese, si dhe të bëjë kripezimin e tyre sipas standardit (0.015kg/m² rrugë), për të garantuar rrugë të pastra dhe pa probleme në qarkullimin e mjeteve gjatë periudhës së dimrit.*

Argumentim: Në bazë të nenit të 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar,

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion kerkesat e cilesise për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

III.2.3. Në shtojcën 6, “Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të Ekzekutimit” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi është përcaktuar si më poshtë:

Shërbimet që kërkohen:

Dite sherbimi gjithesej 730 (dite) per rreth 423,000 kg mbetje urbane te Spitalit, per te gjithë periudhen e sherbimit.

Afatet e ekzekutimit: Per sa i perket sherbimit dhe grafikut te kryerjes se sherbimit, kjo do te percaktohet rast pas rasti ne minikontratat qe do te lidhen, ne zbatim te marrveshjes kuader.

III.2.4. Neni 2 Qëllimi i ligjit 162/2020 Për Prokurimin Publik, parashikohet shprehimisht se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë*

pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Neni 3, Parime të përgjithshme 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.2.5. Neni 21, Autoriteti ose enti kontraktor 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.6. Neni 34, Përlllogaritja e vlerës së parashikuar të prokurimit 3. Autoriteti ose enti kontraktor në fazën e hartimit të nevojave të tyre për mallra, punë, shërbime mbajnë në konsideratë metodat e përlllogaritjes së vlerës së prokurimit. Vlera e përlllogaritur e prokurimit duhet të jetë vlerë reale përpara dërgimit për publikim të njoftimit të kontratës.

III.2.7. Neni 1 i VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” parashikon shprehimisht se: Autoriteti/enti kontraktor është përgjegjës për menaxhimin e fondeve publike të përcaktuara për përdorim në prokurimet publike, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.162/2020, “Për prokurimin publik” (në vijim, LPP), të këtyre rregullave, dhe udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik (në vijim, APP), të dala në bazë dhe për zbatim të LPP-së.

2. Autoriteti/enti kontraktor ka detyrimin të planifikojë në cilësi dhe në kohë nevojat e tij e fondet publike respektive dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.8. Neni 13, “Studimi paraprak i tregut”, i VKM Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikon shprehimisht se:

Përpara se të nisë një procedurë prokurimi, autoriteti/enti kontraktor mund të studiojë tregun, me qëllim që të përgatisë prokurimin, të përditësojë të dhënat që ka përdorur për hartimin e buxhetit dhe regjistrave të parashikimit, si dhe të informojë operatorët ekonomikë për planet dhe kërkesat e tyre për prokurim.

2. Studimi i tregut ka për qëllim përlllogaritjen e një vlere reale të kontratës dhe të shmangë dështimin e procedurës për vlera që nuk përputhen me vlerat reale të tregut.

3. Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit ngarkon me detyrë për studimin e tregut, një ose disa persona, që mund të jenë një grup pune i ngritur për këtë qëllim çdo fillim viti, ose rast pas rasti.

4. Për studimin e tregut, autoriteti/enti kontraktor, mund të konsultohet me ekspertë, autoritete të pavarura ose operatorët ekonomikë në treg me shkrim ose verbalisht. Në rastin e konsultimit verbalisht, grupi i ngritur për këtë qëllim, harton një procesverbal me këto të dhëna. Këto këshilla mund të përdoren në planifikimin dhe kryerjen e procedurës së prokurimit, nëse nuk rezultojnë në 15 shtrembërimin e konkurrencës dhe cenojnë parimet e mosdiskriminimit dhe transparencës

III.2.9. Neni 76, “Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit”, i VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” parashikon shprehimisht se:

1. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe

b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe

c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Autoriteti/enti kontraktor mund t’i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

2. Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.

3. *Për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, titullari i autoritetit/entit kontraktor mund të caktojë struktura të posaçme. Në rast se nuk ngrihen struktura të posaçme, kjo detyrë i ngarkohet specialistit të fushës ose njësisë së prokurimit.*

III.2.10. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 319 datë 31.05.2018 të Këshillit të Ministrave “*Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të Integruar të Mbetjeve*”, parashikohet shprehimisht se :

Sistemi standard i llogaritjes së kostos për menaxhimin e mbetjeve për një (njësi e vetëqeverisjes vendore) NJVV të vetme duhet të bazohet në të paktën 6 nga blloqet e të dhënave të mëposhtme:

1. *Të dhënat e përgjithshme për njësinë administrative apo zonën e shërbimit (blloku 1);*
2. *Investimet kapitale (kamionët dhe kazanët e nevojshëm) (blloku 2);*
3. *Kostot operative (mirëmbajtje, transport dhe personel) (blloku 3);*
4. *Kostoja për trajtim në landfill (tarifa e trajtimit) (blloku 4);*
5. *Kostot e amortizimit (riinvestimit) (blloku 5);*
6. *Kostot administrative (blloku 6);*
7. *Përlllogaritja e kostove totale të shërbimit (blloku 7). Të gjitha pikat e mësipërme dhe elementet përkatëse që i përmbledhin ato, mund të modelohen në sistem bazuar në programin Excel, i cili duhet të jetë në gjendje të ofrojë të gjithë infrastrukturën përkatëse, burimet njerëzore dhe mjetet financiare të nevojshme për funksionimin e sistemit të menaxhimit.*

III.2.11. Në pikën 3 të vendimit të sipërcituar parashikohet se: “*Ngarkohen të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.*” Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është detyrim për të gjithë njësitë e qeverisjes vendore, që jo vetëm në përlllogaritjen për kryerjen e shërbimit t’i referohen vendimit të mësipërm, por njëkohësisht duhet të sigurohen, se zbatuesit e kontratave publike të ofrimit të shërbimit, në përlllogaritjen e kostove të shërbimit, i janë referuar aktit nënligjor në fuqi.

III.2.12. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se fondi limit është një ndër elementet e rëndësishme të një procedure prokurimi, që përcaktohet që në nisjen e saj në urdhrin e prokurimit, siç përcaktohet në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik dhe në bazë të fondit limit bëhet përzgjedhja e llojit të procedurës, si dhe hartohen dokumentet standarde të tenderit. Vlera limit e kontratës publike është shuma totale, e pagueshme, pa TVSH, e llogaritur nga autoriteti kontraktor përpara dërgimit për botim të njoftimit të procedurës së prokurimit. Për përlllogaritjen e fondit limit të procedurës së prokurimit janë përcaktuar mënyrat konkrete, të cilat gjejnë rregullim në nenin 76 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”. Në dispozitën e sipërcituar parashikohet shprehimisht, se në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë

alternativave si vijon: a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe **c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;** ose/dhe ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht. Në rastin konkret, referuar informacionit të autoritetit kontraktor dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe specifikës së objektit të prokurimit, i cili në këtë rast rregullohet edhe me VKM nr.319 datë 31.05.2018 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të Integruar të Mbetjeve”, rezulton se në shkresën nr. 460 prot, datë 08.03.2024, protokolluar me tonën me nr. 555/2, datë 12.03.2024, me lëndë “Dërgim Informacioni”, nga autoriteti kontraktor është sqaruar në lidhje me metodologjinë e përlllogaritjes së fondit limit, ku citon se: “Grupi i punes konstaton se pranë institucionit tone kemi kontrata te ngjashme për evadimin e mbetjeve urbane dhe pastrimin e rrugëve nga debora, të cilat janë realizuar mbi bazën e Marrveshjeve Kuader respektive, marrëveshje te lidhura per periudha 2 - vjeçare, dhe konkretisht grupi i punes u referua në: **1- Kontrata Nr. 1315 prot. date 01.10.2021 “Largim, përpunim i mbetjeve (urbane) dhe pastrim i territorit nga debora, Spitali Korçe”, lidhur mbi Marreveshjen Kuader nr. 497 prot. date 25.03.2020, per periudhen 2020 – 2022;. 2- Kontrates Nr. 207 prot. date 01.02.2024 “Largim, përpunim i mbetjeve (urbane) dhe pastrim i territorit nga debora, Spitali Korçe”, lidhur mbi Marreveshjen Kuader nr. 538 prot. date 25.03.2022, per periudhen 2022 - 2024. (Kontratat bashkelidhur relacionit). Grupi i punes bazuar ne kete metodike, perlllogariti cmimin mesatar për sherbimin si me poshte: Cmimi kontrata 01.10.2021 = 1884 leke / dite pa TVSH; Cmimi kontrata 01.02.2024 = 1712.3 leke / dite pa TVSH; Cmimi mesatar = 1798.15 leke / dite pa TVSH. Per sa me sipër, bazuar ne tabelën bashkalidhur ketij relacioni, si dhe ne faktin se periudha 24 - mujore për prokurim eshte 730 dite kalendarike Vlera Totale e kesaj procedure prokurimi eshte: 1798.15 leke / dite pa TVSH × 730 dite = 1 312 649.5 leke pa TVSH. Referuar pikes 1 te nenit 34 te Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe pikes 1 te nenit 12 te VKM-se nr.285/2021 “Për miratimin e rregullave te prokurimit publik”. eshte e percaktuar se, llogaritja e vleres se parashikuar te nje prokurimi, bazohet ne shumën totale qe duhet paguar pa TVSH, për “Evadim i mbetjeve urbane”, te Spitalit Korçe per 24 muaj (2024 - 2025)” objekt i Urdhrit Nr. 8, me nr. 164 prot, date 29.01.2024, vlera totale e perlllogaritur per 24 muaj eshtë 1,312,649.5 (nje milion e treqind e dymbedhete mije e gjashteqind e dyzet e nente pike pesë) Leke pa TVSH. Pra per sa me siper ndodhur ne kushtet e shtjelluara AK eshte referuar tek; kriteri **c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete te tjera kontraktore;** ç) çmimet nderkombetare te shpallura publikisht, (per kete procedure prokurimi me kete objekt prokurimi ne dijenine tone NUK ka cmime sipas kerkeses se kesaj pike). Duke analizuar per sa me siper, mendojme se perlllogaritja e fondit limit per kete procedure prokurimi eshte e bazuar ne ligj, pra perlllogaritja e fondit limit per kete procedure prokurimi eshte bere ne nje nga menytrat ligjore te percaktuara ne VKM nr. 285 dt. 19.05.2021 “Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, te ndryshuar, neni 76 “Menyrat per perlllogaritjen e vlerës se prokurimit”. Gjithashtu, ka**

bashkëngjitur procesverbalin e perlllogaritjes së fondit limit të procedurës së prokurimit objekt - shqyrtimi.

III.2.13. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Nga shqyrtimi i pretendimeve të ankimuesit, dokumenteve të tenderit, si dhe kthim përgjigjes së autoritetit kontraktor, Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor në hartimin e fondit limit të procedurës së prokurimit, i është referuar përcaktimeve të nenit 76 “Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit”, i VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar në të cilin ndër të tjera përcaktohet se *në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, ku ndër alternativat është edhe çmimi i kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;* përlllogaritje mbi të cilën është mbështetur edhe autoriteti kontraktor për fondin limit të kësaj procedure prokurimi. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, mënyra e përlllogaritjes së fondit limit është lënë në të drejtën e autoritetit kontraktor, por gjithmonë duke respektuar *alternativat e renditura* në nenin 76 të VKM-së 285/2021. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se për sa kohë një detyrim i tillë është i përcaktuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përzgjedhë mënyrat e përlllogaritjes së fondit limit në përputhje me dispozitat ligjore, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik.

Referuar shtojcës 5 “Formulari i Specifikimeve Teknike” të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor ka përcaktuar se “*operatori ekonomik kontraktues detyrimisht kryen larjen e kontejnerëve me ujë dhe solucion, minimumi 1 (një) herë në muaj, si dhe disinfektimin e kontejnerëve dhe truallit të vendgrumbullimit me klor çdo ditë. Operatori ekonomik kontraktues duhet të beje hapjen dhe kripezimin e rrugeve brenda teritorit të spitalit, nga dëbora gjatë muajve të dimrit. Operatori ekonomik kontraktues, duhet të pastrojë rrugët e brendëshme të Bllokut Spitalor nga bora, në të gjithë gjatësinë e tyre, me mjete borëpastruese, si dhe të bëjë kripezimin e tyre sipas standartit (0.015kg/m² rrugë), për të garantuar rrugë të pastra dhe pa probleme në qarkullimin e mjeteve gjatë periudhës së dimrit*”, ndërsa në shtojcën 6 “Formulari i Shërbimeve dhe Grafiku i Ekzekutimit” të procedurës së prokurimit objekt – shqyrtimi, Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor ka përcaktuar ditët e shërbimit që janë gjithsej 730 ditë, si dhe sasinë prej 423.000 kg mbetje urbane të spitalit, ndërkohë këto shërbime nuk janë parashikuar në preventiv, shtojcën 2 (lista e çmimeve të artikujve), si zë më vetë. Akoma me tej, duke iu referuar edhe objektit të kontratës rezulton, se kemi të bëjmë me një shërbim kompleks, pra edhe atë të shërbimit të pastrimit të rrugeve brenda

territorit të spitalit nga dëbora dhe kripëzimin e tyre, si dhe largimin dhe përpunimin e mbeturinave urbane të cilat rregullohen më VKM të posaçme VKM 319 datë 31.05.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për përcaktimin e nevojave të tij për mallra, shërbime e pune, duke përcaktuar për secilën prej tyre sasi dhe zërat përkatëse dhe të duhura sipas nevojave të tij dhe specifikimet teknike të tyre, duke përcaktuar edhe fondin limit për një objekt të caktuar prokurimi. Pra, është përgjegjësi e autoritetit kontraktor, si organi me interes të drejtëpërdrejtë për kryerjen e procedurës së prokurimit, si edhe organi përgjegjës për mirëpërdorimin e fondeve publike, të përcaktojë fondin limit të procedurës së prokurimit, në përputhje me natyrën e mallrave dhe shërbimeve, si dhe në përputhje me specifikimet teknike dhe termave të referencës, në zbatim të neneve 13 dhe 76 të rregullave të prokurimit publik si më sipër cituar, por në rastin konkret për shkak të specifikës së objektit të prokurimit, i cili përveç përcaktimeve ligjore më sipër për disa zëra shërbimi e konkretisht për zërat **largim përpunim i mbeturinave urbane, Transport i mbetjeve urbane, Menaxhim mirëmbajtje kontenierësh, larje me solucion dhe disinfektim e kontenierëve dhe të truallit të vendgrumbullimit**, ka rregullim të posaçëm me VKM nr. 319 datë 31.05.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të Integruar të Mbetjeve”, gjë për të cilën në informacionin e dërguar nga autoriteti kontraktor, nuk figuron që ky i fundit të jetë mbështetur ndër të tjera edhe mbi këtë VKM në perlllogaritjen e fondit limit. Lidhur me këtë konstatim, KPP gjykon, se në rastin konkret, autoriteti nuk ka parashikuar në preventiv të gjithë zërat e shërbimit që kërkon të kryhen referuar specifikimeve teknike. Gjithashtu, në hartimin e fondit limit për sa i përket zërave **largimit përpunimit të mbeturinave urbane, Transportit të mbetjeve urbane, Menaxhimit të mirëmbajtjes së kontenierëve, larjen me solucion dhe disinfektimin e kontejnerëve dhe të truallit të vendgrumbullimit**, autoriteti kontraktor nuk ka mbajtur në konsideratë përcaktimet në VKM nr. 319, datë 31.05.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të Integruar të Mbetjeve”, duke shkaktuar konfuzion tek operatorët ekonomikë sa i takon ndërtimit të ofertës së tyre ekonomike, por edhe dështim të procedurës së prokurimit për pamjaftueshmëri të fondit limit për realizimin e kontratës.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik bazuar në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, *Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin*; nenin 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji ku thuhet shprehimisht: “*Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj*”, si dhe në nenin 45, pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: “[...]Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimtarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) *Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë*

plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” [...], në këto kushte, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë parashikimet e këtij vendimi, duke hartuar specifikimet teknike dhe preventivin e kontratës të unifikuara, në përputhje me VKM nr. 319, datë 31.05.2018, “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të Integruar të Mbetjeve”, si dhe në përputhje me nevojat reale të autoritetit.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Rej” SHPK qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Rej” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr.REF-96533-02-27-2024, me objekt: “Largim perpunim i mbeturinave (urbane) dhe pastrim i territorit nga dëborat, Spitali Korçë” – Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik, ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 24 muaj”, me fond limit 1,312,649.5 (një milion e treqind e dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e nëntë pikë pesë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 11.03.2024, nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Shërbimit Spitalor Korçë.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës, të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Rej” SHPK.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

